

**DEKRET<sup>1</sup>**  
**Nr.782, datë 22.2.1994**  
**PER SISTEMIN FISKAL NE SEKTORIN E HIDROKARBUREVE (KERKIM - PRODHIM)**

**I MIRATUAR DHE NDRYSHUAR ME:**  
**LIGJIN NR.7811, DATË 12.4.1994 "PER MIRATIMIN ME NDRYSHIME TE DEKRETIT NR.782,**  
**DATE 22.2.1994 "PER SISTEMIN FISKAL NE SEKTORIN E HIDROKARBUREVE (KERKIM-**  
**PRODHIM)"**

**I NDRYSHUAR ME:**  
**LIGJIN NR.8345, DATË 13.5.1998**  
**LIGJIN NR.10049, DATE 24.12.2008**  
**LIGJIN NR.32/2012, DATË 21.03.2012**  
**LIGJIN NR.183/2013, DATË 28.12.2013**

Në mbështetje të nenit 28, pika 19, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave, Dekretoj,

Neni 1

1.<sup>2</sup> "Kontraktuesi detyrohet të paguajë, në çdo vit fiskal, tatimin mbi fitimin e realizuar në atë vit fiskal, si dhe taksën e rentës minerare për hidrokarburet që nxjerr nga nëntoka. Tatimi mbi fitimin tërhiqet në para, siç parashikohet në çdo marrëveshje hidrokarburesh. Taksa për rentën minerare paguhet në sasinë dhe sipas procedurave, që përcaktohen në ligjin nr.9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare".".

Tatimi mbi fitimin është:

1. Në masën 50 për qind të fitimit të realizuar.

3.<sup>3</sup> Për shfrytëzimin e vendburimeve margjinale të zbuluara, ose të kthyer në margjinale nga shfrytëzimi i tyre, Këshilli i Ministrave mund të nxjerrë vendime të posaçme për lehtësimin e sistemit fiskal, me qëllim vetëm që këto lloj vendburimesh të kthehen në ekonomiksht të shfrytëzueshme.

Neni 2

Për efekt të llogaritjes së fitimit të realizuar, kontraktuesit i njihen si kosto shpenzimet kapitale, ato operative e administrative etj. (specifikimet përkatëse bëhen në çdo marrëveshje hidrokarburesh e miratohen nga ministri) dhe lejohet shlyerja e tyre nga të ardhurat e fituara sipas kriterëve të pranuar nga ministri, si dhe sipas praktikave ndërkombëtare të industrisë së naftës që zbatohen në çdo marrëveshje hidrokarburesh.

Neni 3

Kontraktuesi dhe nënkontraktuesit e tij përjashtohen nga detyrimet doganore për pajisjet, makineritë, materialet etj.

Paragrafi i dytë i nenit 3 të formulohet:

4"Gjithashtu, trajtohen njëjloj si në paragrafin e mësipërm të këtij neni edhe sendet e përdorimit vetjak të punonjësve të huaj, të kontraktuesit e nënkontraktuesve të tij, që lidhen me operacionet e hidrokarbureve"<sup>5</sup>

---

<sup>1</sup> Ky Dekret është miratuar me Ligjin Nr.7811, datë 12.4.1994 "PER MIRATIMIN ME NDRYSHIME TE DEKRETIT NR.782, DATE 22.2.1994 "PER SISTEMIN FISKAL NE SEKTORIN E HIDROKARBUREVE (KERKIM-PRODHIM)"

<sup>2</sup> Ne zbatim te nenit 1, te ligjit nr. 10049, date 12.04.1994, pika 1 e nenit 1 e ligjit 7811, date 12.04.1994 ndryshohet.

<sup>3</sup> Ne zbatim te nenit 1 te ligjit nr. 32/2012, pika 2 e nenit 1 te dekretit shfuqizohet.

<sup>4</sup> Ne zbatim te nenit 1, pika 2, te ligjit nr. 7811, date 12.04.1994, Paragrafi i dytë i nenit 1 të dekretit riformulohet.

<sup>5</sup> Ne zbatim te nenit 1, te ligjit nr. 183/2013, neni 4 I dekretit shfuqizohet